



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Prishtinë, 14 Maj, 2026

THIRRJE PUBLIKE PËR PËRKRAHJE FINANCIARE E PROJEKTEVE TË OJQ-VE PËR SHËRBIME SOCIALE E FAMILJARE

për ofrimin e përkrahjes financiare publike projekteve të organizatave joqeveritare (OJQ-ve) që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për individët, familjet dhe grupet e cenueshme, e në nevojë në Kryeqytetin e Kosovës Prishtinë

Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Kryeqytetit bazuar në *Strategjinë Komunale për Shërbime Sociale dhe Planin e Veprimt* fton të gjitha OJQ-të e regjistruara në Kosovë që të aplikojnë për mbështetje financiare, duke dhënë përparësi ofrimit të shërbimeve të drejtpërdrejta sociale dhe familjare.

Fokusi kryesor i kësaj thirrjeje është mbështetja e drejtpërdrejtë profesionale për fëmijët, të rriturit dhe familjet në nevojë. Ndonëse thirrja përfshin edhe aspektet kërkimore dhe strategjike, prioritet do të kenë projektet që ofrojnë ndërhyrje konkrete dhe kujdes të drejtpërdrejtë në terren për mbrojtjen dhe fuqizimin e grupeve të rrezikuara në Prishtinë, të cilat janë si vijon;

- Fëmijët /pa përkujdesje prindërore e familjare, në rrezik për humbjen e për kujdesit prindëror;
- Fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, të bullizuar (ngacmuar)/stigmatizuar, dhunën në mes bashkë moshatarëve, të rrezikuara dhe viktimat e krimit kibernetik;
- Të gjitha grupimet e personave (fëmijë, të rritur) me aftësi të kufizuara;
- Viktima të krimit, dhunës në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale;
- Të mbijetuarat e dhunës në familje – ri integrimi dhe fuqizimi
- Prindërit vetëshqyese në gjendje të nevojës sociale
- Vajzat dhe gratë e marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social në viset rurale dhe

- urbane;
- Fëmijë në forma të rënda të punës;
- Fëmijët me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur;
- Të moshuarit në nevojë për përkujdesje familjare e sociale;
- Te miturit në martesat e hershme vajzave dhe djemve – parandalimi dhe vetëdijesimi
- Komunitetet jo shumicë me përkatësi etnike fuqizimi i kujdesit familjar dhe përfshirja sociale;
- Fëmijët me nevoja të veçanta edukative- arsimore – nevoja logopedike,
- Komuniteti LGBTI+ në nevojë për përkrahje me shërbime profesionale e sociale;
- Abuzuesit e substancave psiko-aktive;
- Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike;
- Fëmijët dhe të miturit pa përkujdesje dhe të pa shoqëruar – emigrantë;
- Veteranet dhe invalidët e luftës.

I. Projektet duhet të dizajnohen për të ofruar mbështetje konkrete dhe të matshme për kategoritë e mësipërme, nëpërmjet së cilave, OJQ-të (Organizatave Joqeveritare) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për fushat e përcaktuara si në vijim:

1. **Për Personat me Aftësi të Kufizuara:**

- I. Ofrimi i shërbimeve direkte profesionale (terapi, rehabilitim) dhe njësive mobile për kujdes në shtëpi;
- II. Të cilat ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta sipas nevojave të secilës prej kategorive të personave me aftësi të kufizuar të cilët nuk mund t'i përballojnë koston e këtyre shërbimeve;
- III. Fuqizimin praktik për aftësim profesional dhe mbështetje për jetë të pavarur.
- IV. Krijimi dhe zhvillimi i platformave rekreative dhe mbështetëse për prindërit dhe kujdestarët.

2. **Për Fëmijët dhe të Miturit (pa përkujdesje, viktimat të dhunës apo në situatë rruge):**

- I. Zhvillimi i strehim rezidencial/familjar dhe mbështetje e drejtpërdrejtë psiko-sociale.
- II. Ndërhyrje direkte për mbrojtjen nga bulizmi, krimi kibernetik dhe shfrytëzimi përmes punës.
- III. Programe të socializimit dhe aktivitete ditore për fëmijët në kushte të vështira ekonomike.

3. **Për të Moshuarit dhe Veteranët:**

- I. Shërbime shtëpiake përmes njësive mobile dhe kujdesi i drejtpërdrejtë për shëndetin fizik e mendor.
- II. Shërbime të kujdesit ditor për të moshuarit;
- III. Rehabilitim socio-fizik dhe organizim i jetës aktive shoqërore.

4. **Për Familjet, Gratë dhe Grupet e Margjinalizuara (LGBTIQ+, Komunitetet, Abuzuesit e Substancave):**

- I. Fuqizim ekonomik përmes aftësimin profesional dhe mbështetjes për prindërit vetushqyes.
 - II. Këshillim direkt psiko-social, identifikim dhe referim i rasteve të abuzimit.
 - III. Programe të prindërimit aktiv dhe ri-integrimit social.
 - IV. Fuqizim i drejtpërdrejtë për pavarësi socio-ekonomike;
 - V. Aftësim dhe riaftësim profesional të individëve dhe anëtarëve të familjes.
-

1. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **400,000.00€ (katërqind mijë euro)**.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **500 € (pesëqind euro)** ndërsa shuma maksimale për një projekt është **18,000.00 € (tetëmbëdhjetë mijë euro)**.

2. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, gjegjësisht nga dt. **14.05.2026 deri me datën 04.06.2026**.

3. OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekte në kuadër të kësaj thirrje. Periudha e zbatimit të projektit është nga 6 deri 12 muaj.

4. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të (Organizata Jo qeveritare) që janë të regjistruara sipas dispozitave ligjore për regjistrimin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Prishtinës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën mbrojtjes së grupeve të rrezikuara dhe në nevojë sociale:

5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion për shkarkim në faqen e internetit në linkun në vijim: <https://prishtinaonline.com/drejtore/mireqenia-sociale/subvencionet>

6. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Prishtinës,

Drejtoria për Mirëqenie

Sociale

Rr, UÇK nr 2, 10000, Prishtinë

Qendra për shërbime me Qytetarë

Kati përdhese, sporteli nr.3

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në ***Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.***

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

7. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: urim.seferi@rks-gov.net.